




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

RAPORT STATISTIKOR VJETOR

2020


I. STATISTIKË E PROCESIT



Grafiku nr. 1 - Pasqyrë përmbledhëse e aktivitetit në tërësi

I. 1 - VENDIME TË NJOFTUARA NGA KPK-JA

Institucioni i Komisionerëve Publikë, në referencë të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë periudhës janar-dhjetor 2020, është njoftuar për 103 vendime nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Ecuria e vendimeve të njoftuara në vitet 2018-2019-2020, tregohet në grafikun nr. 2.




Grafiku nr. 2 - Numri i vendimeve të ardhura në IKP në vitet 2018-2019-2020

103 vendimet e ardhura përmbajnë këta dispozitivë:


35	Konfirmime;
38	Shkarkime;
30	Ndërprerje procesi.

Ecuria e ardhjes së vendimeve, konsideruar nën optikën e dispozitivit të tyre, sipas viteve paraardhëse, 2018-2019, për ta treguar atë në mënyrë krahasimore, paraqitet në grafikun e mëposhtëm nr. 3.




Grafiku nr. 3 - Dispozitivi i vendimeve të KPK-së, të ardhura në IPK sipas viteve, 2018, 2019, 2020

Subjektet e rivlerësimit, 103 subjekte në total, për të cilët janë njoftuar vendimet nga KPK-ja, janë të funksioneve të ndryshme. Në grafikun nr. 4 tregohet se numri më i madh është i gjyqtarëve - 69, më pas në trend zbritës: prokurorë - 29, këshilltar ligjor - 1, ish-gjyqtar - 1, inspektor, ish-Këshilli i Lartë - 1, nëpunës i KLGJ- 1, ndihmës ligjor -1, në total “të tjerë”: 5.



Grafiku nr. 4 - Subjektet e rivlerësimit sipas funksioneve, viti 2020

FUNKSIONET E SUBJEKTEVE TË RIVLERËSIMIT NË VITE: 2018-2019-2020




Grafiku nr. 5 - Subjektet e rivlerësimit sipas funksioneve, krahasuar në vite


I.2 - REKOMANDIME TË ARDHURA NGA ONM-JA

Referuar nenit 65/2, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit B, pika “c” e aneksit të Kushtetutës, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit për vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit (neni B, germa “c” e aneksit të Kushtetutës).

Rekomandime nga ONM- viti 2020




Grafiku nr. 6 - Numri i rekomandimeve të ONM-së, të ardhura në IKP, sipas muajve



Grafiku nr. 7 - Numri i rekomandimeve të ONM-së, të ardhura në IKP, sipas viteve


I.3- SHQYRTIMI I VENDIMEVE NGA KOMISIONERËT PUBLIKË

Gjatë vitit 2020, pas shqyrtimit të vendimeve të njoftuara nga KPK-ja, në zbatim të nenit 63, të ligjit nr. 84/2016, Komisionerët Publikë kanë ushtruar të drejtën e ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, për 16 vendime të KPK-së. Për 87 vendime është njoftuar mosankim. Shihni grafikun nr. 8.




Grafiku nr. 8 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë, viti 2020

Ankime, Mosankime në vite: 2018-2019-2020



Grafiku nr. 9- Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë, në vitet 2018, 2019, 2020

Ankime, mosankime sipas funksioneve të s.r. në vite: 2018-2019-2020




Grafiku nr. 10 - Vendimmarrje e Komisionerëve Publikë sipas funksioneve të subjekteve të rivlerësimit, në vitet 2018-2019-2020

I.4- PJESËMARRJA NË SEANCAT E GJYKIMIT TË ANKIMIT TË IKP-SË NË KPA

Referuar neneve 5/2, 63/1, 65/3 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në rastin e ankimit të vendimit të KPK-së, nga Komisioneri Publik, Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) e gjykon çështjen në seancë publike.

Për ecurinë në vite të seancave gjyqësore publike është ndërtuar grafiku nr.11, ku jepet qartë për secilin vit ecuria e: numrit të seancave për secilin subjekt rivlerësimi, numrit të subjekteve të rivlerësimit të gjykuar në KPA dhe numrit të proceseve të përfunduara.



Grafiku nr. 11 - Numri i seancave dhe i subjekteve të rivlerësimit në total për vitet: 2018, 2019, 2020


II. DENONCIMET NGA PUBLIKU

Për vitin 2020, në total janë administruar 165 denoncime, të cilat janë njoftuar në IKP:

5- denoncime direkt nga denoncuesi (pritja e tij), 141- nëpërmjet postës zyrtare, 19- nëpërmjet postës elektronike, info@ikp.al.


Në grafikët nr. 12, 13 jepen të pasqyruara denoncimet nga publiku sipas mënyrës së hyrjes së tyre në IKP dhe sipas muajve të vitit.

NJOFTIMET E DENONCIMEVE NGA PUBLIKU-VITI 2020



Grafiku nr. 12 - Numri i denoncimeve nga publiku sipas mënyrës së njoftimit


DENONCIMET NGA PUBLIKU SIPAS MUAJVE - VITI 2020



Grafiku nr. 13 - Shpërndarja e denoncimeve nga publiku sipas muajve, viti 2020


Në grafikun e mëposhtëm me nr.14 tregohet numri i denoncimeve në total, të administruara në IKP, numri i denoncimeve të shqyrtuara nga Njësia Ligjore, si dhe numri në total i subjekteve të denoncuara.

Denoncime nga publiku në IKP- viti 2020




Grafiku nr. 14 - Pasqyrë përmblledhëse e administrimit të denoncimeve në IKP

Denoncime nga publiku sipas funksionit të subjekteve të rivlerësimit- viti 2020



Grafiku nr. 15 - Numri i denoncimeve sipas funksionit të subjekteve të rivlerësimit, viti 2020

Krahasuar me vitin 2018 dhe 2019, në grafikun nr. 16 rezulton kjo ecuri:



Grafiku nr. 16- Ecuria e denoncimeve nga publiku në IKP për vitet 2018-2019-2020

III. TRAJTIMI I KËRKESAVE PËR INFORMACION NGA PUBLIKU

Sipas nenit 8 të ligjit nr. 119/2014, në Institucionin e Komisionerëve Publikë, nën përgjegjësinë e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, trajtohen kërkesat për informacion nga publiku, duke administruar Regjistrin e Kërkesave dhe të Përgjigjeve, i cili publikohet në faqen zyrtare të institucionit dhe përditësohet çdo tre muaj.

Grafiku nr. 17 pasqyron ecurinë e kërkesave të trajtuara në IKP, për vitet 2018-2019-2020, ku rezulton se numrin më të lartë e ka viti 2019.




Grafiku nr. 17 - Numri i kërkesave për informacion të trajtuara në IKP

IV. SITUATA BUXHETORE PËR VITIN 2020, PËR INSTITUCIONIN E KOMISIONERËVE PUBLIKË

Në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimi në %
Shpenzime korente	66,350	66,050	62,808	95 %
Shpenzime kapitale	1,000	1,000	579	58 %
TOTALI	67,350	67,050	63,387	94.5 %




Grafiku nr. 18 - Situata buxhetore në vitin 2020

Performanca e realizimit të fondeve buxhetore për vitin 2020 është në nivelin 94.5% ose rreth 1% më e lartë se në vitin 2019, dhe kryesisht kjo rritje vërehet në realizimin e shpenzimeve të personelit.

Për sa i përket shpenzimeve të kryera për furnizimin materialo-teknik të stafit të institucionit, administrimin e institucionit, krijimin e kushteve optimale për përballimin e situatës së jashtëzakonshme që kishte ky vit, sa i përket mbrojtjes së jetës së punonjësve dhe ndërthurjen e procesit të punës në zyrë me atë *online*, theksojmë se janë kryer konform fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2020 dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

Numri i procedurave të prokurimit viti 2020




Grafiku nr. 19 - Ecuria e procedurave të prokurimit, të zhvilluara në vitin 2020

Në mënyrë analitike, performanca e objektivave dhe e realizimit të shpenzimeve për vitin 2020, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet në vijim:

Realizimi i buxhetit sipas artikujve ekonomikë

Në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimi në %
600+601	Paga dhe sigurime	57,000	60,500	60,397	99,8 %
602+606	Shpenzime për mallra dhe shërbime, dhe fondi i veçantë	9,350	5,550	2,411	43.4 %
231	Shpenzime kapitale	1,000	1,000	579	58 %
	TOTALI	67,350	67,050	63,387	94.5 %




Grafiku nr. 20 - Realizimi i buxhetit 2020 sipas artikujve (në %)

Në mënyrë analitike, realizimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2020, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet në vijim në formë tabelore dhe grafike, për çdo projekt investimi.

Në mijë lekë

Investimet	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimi në%
Blerje pajisje elektronike	550	550	460	83.6%
Blerje pajisje dhe mobilie zyre	450	450	119	26.4%
TOTALI	1,000	1,000	579	58%



Grafiku nr. 21 - Realizimi i investimeve për vitin 2020 sipas projekteve (në mijë lekë)